

“BEST BETON” SH.P.K. PRISHTINË

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Për bazën e prodhimit të betonit në Milloshevë, Obiliq



Dhjetor, 2025

“BEST BETON” SH.P.K. PRISHTINË

**RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Për bazën e prodhimit të betonit në Milloshevë, Obiliq

Hartues i VNM-së:

Dr.sc. Raif Bytyçi, inxh. i mjedisit, person fizik i licencuar

Aplikon për Pëlqim Mjedisor:

“BEST BETON” SH.P.K.

Dhjetor, 2025

PËMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT.....	6
2.1 Rregullativa ligjore.....	6
2.2. Metodologjia e punës.....	8
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT.....	9
3.1. Potencialet ekzistuese	9
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit.....	10
3.3. Popullsia dhe vendbanimet	16
3.4. Infrastruktura ekzistuese	17
3.5. Kushtet klimatike.....	18
3.6. Gjendja hidrologjia.....	18
3.7. Flora dhe Fauna.....	19
3.8. Karakteristikat sizmike	19
3.9. Peizazhi	10
3.10. Ajri	20
3.11.Uji	21
3.12. Toka.....	21
3.13 Zhurma	22
3.14. Trashëgimia kulturore	22
4. PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK	23
4.1.Prodhimet nga betoni	30
4.2.Komponentët në procesin e prodhimit të betonit	30
4.3.Përshkrimi i procesit teknologjik te prodhimit te betonit	33
4.4. Kosto e investimi në bazën për prodhimin e betonit	37
4.4. Alternativat e projektit	38
5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS	39
5.1. Ndikimet ne ajër	39
5.2. Ndikimet ne tokë	39
5.3. Ndikimet ne ujëra	40
5.4. Ndikimi në peizazh	40
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	41

5.6. Ndikimet nga zhurma	41
5.7. Ndikimet ne raste te aksidenteve ne mjedisin jetësor dhe shëndet	41
5.8. Ndikimet nga mbeturinat dhe menaxhimi i tyre	42
6. MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	43
6.1. Masat për mbrojtjen e ajër	43
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës	43
6.3. Masat për mbrojtjen e ujërave	44
6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma	45
6.5. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	46
7. MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE TË BETONIERËS	46
8. MONITRORIMI DHE RAPORTIMI	50
9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE	51
9.1. Përshkrimi i shkurt i procesit	51
9.2. Ndikimet ne mjedis	51
9.3. Masat mjedisore	52
10. PËRFUNDIME	54
SHTOJCA	55

1. HYRJE

Për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Milloshevë, Obiliq, nevojitet të bëhet analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis për procesin teknologjik të prodhimit të betonit dhe mjedisin.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të nevojshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor dhe pastaj për marrjen e lejes mjedisore dhe operimin e bazës së betonit.

Baza e prodhimit të betonit, gjendet në Milloshevë, në periferi të Obiliqit, në zonë ekonomike të përshtatshëm për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Përmes këtij raporti të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mundë të paraqiten në relacionin baza e prodhimit të betonit dhe mjedisi jetësor duke marrë parasysh mjedisin e gjerë.

Hartimi i raportit të VNM-së bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i bazës së prodhimit të betonit me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtaritë punuese, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është punuar duke u bazuar në gjendjen aktuale të objektit - bazës së betonit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit dhe dokumentacionin teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjër në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së aktiviteteve të punës të bazës së prodhimit të betonit dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës së bazës së prodhimit të betonit “Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Raporti i VNM-së është hartuar ne baze të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/l-181 (2023), i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ky Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidentinë mjedis gjatë funksionimit të bazës për prodhimin e betonit dhe atë:

- identifikimin e burimit të ndotjes që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore për hartimin e VNM-së

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për Bazën e prodhimit të betonit “Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq, janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme në vend, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/l-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11

- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturine.

b) Dokumentacioni teknik

- Gjendja reale aktuale e Bazës së prodhimit të betonit “ Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq me objektet përcjellëse – dokumentacioni përkatës
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit
- Pëlqimin e komunës ose njoftim - informatë sipas PZHK.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënëuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për Bazën e prodhimit betonit “Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq., me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore.

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin e Bazës për prodhimin e betonit “Best Beton” sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik.

Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjenaktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Për hulumtimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit është me rëndësi hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit të projektit, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyrorë siç janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna.

Çdonjëra nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë në analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme.

Në bazë të raporteve relevante mjedisore është e qartë që faktorët natyrorë formojnë disa potenciale natyrore karakteristika funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të stacionit të karburanteve të ndërtuar në hapësirën e lartcukur.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit dhe objekteve

Lokacioni ku është duke u vendosur baza e betonit gjendet në pjesën gjeografike që administrativisht i takon Obiliqit, në afërsi Termocentralit Kosova B, në afërsi të rrugës Obiliq- TC Kosova B- Milloshevë, në lokacionin e zonës komercioale. Baza për prodhimin e betonit “Best Beton” sh.p.k. gjendet saktësisht në Zona Kadastrale Milloshevë, KK Obiliq në ngastrat: P-72614051-00883-2 dhe P-72614051-00884-2.

Përgjithësisht, kjo zone është e pasur në aspektin mjedisor, me një florë – vegjetacion, e dominuar si rajon fushor, me vendbanime përreth afërsi dominohen me hapësira të gjelbëruara, ara dhe kullosa, toka pune.

Lokacioni gjendet në anën e majte të rrugës lokale Obiliq - Milloshevë. Lokacioni i projektit në tërësinë e Kosovës, shihet në pjesët e hartave topografike të më poshtme, figura 1.




Figura 1. Pozita e komunës së Obiliqit në tërësinë e Kosovës




Figura 2. Lokacioni i “Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq.

Lokacioni posedon infrastrukture complete, rrugë të përshtatshme që i mundëson kontakt të përhershëm e të lehtë me të gjitha rrugët e Komunës së Obiliqit dhe gjithë Kosovës.

Këtë e mundëson pozita gjeografike dhe rrjeti i mirë rrugor në këtë zonë që është mjaftë i zhvilluar në aspektin industriale, afër kompleksit energjetik të TC Kosova B.

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në koordinatat 42° 41’ të gjerësisë veriore gjeografike dhe 21° 05’ të gjatësisë lindore gjeografike.

Është i vendosur në mes të rrafshit të Kosovës afër lumenjve Sitnicë dhe Llap, ka një pozitë të mirë gjeografike duke u kufizuar me: Prishtinën, Fushë Kosovën, Glogocin, Vushtrrinë dhe Besianën. Territori i komunës së Obiliqit shtrihet në një sipërfaqe prej 105 km² dhe zë rreth 1 % të territorit të përgjithshëm të Kosovës.

Këtë sipërfaqe e përbën një relief i ndryshëm me teren malor, sipërfaqe fushore dhe të

rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa në perëndim reliefi ngritet në kodra e lugina të malit Çyqavica. Edhe në anën veriore reliefi është i ngritur në kodra e lugina të malit të Albanikut (Kopaonikut).

Komuna e Obiliqit është qendër ekskluzivisht industriale me dy termocentrale dhe me rezerva të mëdha të thëngjillit të cilat shtrihen në mes të luginës së lumit Sitnicë dhe lumit Drenicë në një gjatësi prej rreth 32 km në drejtim veri-jug dhe një në gjerësi rreth 12 km. Ne vijim pamjet e Bazës për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq.



Figura 3. Baza për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq

Përshkrimi i lokacionit në afërsi të drejtpërdrejt të ngastrës së bazës së betonit:

Ngastra e Bazës për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq, gjendet në anën e majtë në rrugën Obiliq – Milloshevë, zone komerciale, në afërsi të qytetit të Obiliqit, përkatësisht të TC Kosova B. Shih figurën 1&2 (lokacioni i bazës për prodhimin e betonit) dhe figura 3 (pamjen e Bazës për prodhimin e betonit).

Lokacioni i Bazës për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq, me objektet përcjellëse, gjendet në zonë komerciale –, *lokacioni i ngushte i betonierës, si në vijim:*

Në veri- parcela e bazës për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, kufizohet me hapësirë të lirë – toka pune, ara dhe kullosa. Pamjet në figurën 4, në vijim.



Figura 4. Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit – pamja ne veri

Në lindje – parcela e bazës për prodhimin e betonit “Best Beton” sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq, kufizohet me hapësirë të lirë, toka të destinuara për qëllime investive biznesore. Pamjet në figurën 5, në vijim.



Figura 5. Pamjet në lindje të bazës për prodhimin e betonit

Në jug – parcela e bazës për prodhimin e betonit “Best Beton”sh.p.k. në Milloshevë, Obiliq, kufizohet me qasja në rrugën lokale ku ka qasje betoniera dhe qe e lidhe me rrugën Obiliq- Milloshevë, përtej hapësirë e lire ne disa qindra metra. Pamjet në figurën 6, në vijim.



Figura 6. Pamjet në jug të bazës për prodhimin e betonit

Në perëndim – Parcela e betonierës kufizohet me rrugën lokale dhe përtej zone e lire. Përkatësisht në anën perëndim të parcelës, gjenden dhe hapësira tjera të destinuara për biznese dhe parcela të lira, toka pune dhe kullosa. Pamjet në figurën 7.



Figura 7. Pamjet në perëndim të bazës për prodhimin e betonit

Në bazë të këtij përshkrimi të gjendjes dhe gjitha analizave është paraqitur mundësia për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor të lokacionit si dhe ndikimeve të mundshme në mjedis, gjatë punës së bazës për prodhimin e betonit.

Ne shtojcë të VNM-së do të bashkëngjitet edhe Plani i situacionit – nga gjeodeti i licencuar, që definon vendosjen e objekteve dhe pajimeve të betonierës në parcelë dhe distancat përkatëse.

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Njërin nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj.

Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar. Dendësia mesatare e popullsisë është mbi 300 ban/km². Komuna e Obiliqit cilësohet me lëvizje migruese lokale dhe dislokim të komplet fshatrave për shkak të shfrytëzimit të thëngjillit nga mihja sipërfaqësore.

Të dhënat për popullsinë flasin se pas vitit 1999, depopullimi më imadh ka ndodhur në qytetin e Obiliqit, në Dardhishtë dhe në Hade. Në tërë Komunën gravitojnë rreth 20 vendbanime duke përfshirë edhe vetë qytetin e Obiliqit.

Zonat Kadastrale janë: Hade, Babimoc, Bakshi, Breznicë, Cërkvëna Vodice, Dobrosellë, Graboc i Epërm, Hamidi, Dardhishtë, Llazarevë, Leshkoshiq, Mazgit, Milloshevë, Obiliq, Plemetin, Raskovë, Siboc, Shipitullë.

3.4. Infrastruktura ekzistuese

Në komunën e Obiliqit ekziston një infrastrukturë relativisht e zhvilluar dhe atë në segmente të ndryshme, por natyrisht që ka nevojë për zhvillimin e mëtutjeshëm të saj me qëllim të ngritjes së nivelit të zhvillimit të saj dhe të zgjerimit të shërbimeve publike që varen shumë nga infrastruktura. Infrastruktura rrugore.

Rrugët kryesore që kalojnë mepërmes zonës janë rrugët rajonale R220, që kalon (paralel me M2) nëpër Prilluzhë, Plemetin, Obiliq dhe Krushevc (Dardhishtë) e që lidhet në M2 si dhe asaj që ndanë në dysh zonën minerare R120, që vjen nga M2 dhe kalon përmes Obiliqit, Caravadicës (Palaj), Hades, Grabovcit të Poshtëm, Bardhit të Madh e deri në Sllatinë të Vogël ku kyçet në M9. Rrugët tjera, janë ato lokale dhe qendrat e tyre urbane si dhe me vendbanimet më të afërta ndërkomunale.

Infrastruktura ekonomike - Industria është një sektor shumë i rëndësishëm me aktivitetet e saj përcjellëse të territorit të komunës së Obiliqit. Po ashtu edhe përqindja e të punësuarve në këtë sektor, është më e madhe se sa në sektorët tjerë.

Sigurisht që pjesa dërmuese e tyre janë të punësuar në energjetikë. Bartësit kryesor të zhvillimit në kete regjion sot janë termoelektranat, minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I – IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë dhe aktivitetet që zhvillohen përgjate kesaj rruge.

3.5. Kushtet klimatike

Zona i nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko teknologjike si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike.

Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolet dhe elementet e tjera klimatologjike.

Për shkak të proceseve kimiko teknologjike, zona ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që variron nga 95% - 47%, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45 - 56%.

Temperaturat minimale dhe maksimale mujore - mesatarja e temperaturës minimale, gjatë muajit: Shkurt, rreth -7.7 celsius. Ndërsa mesatarja e temperaturës maksimale gjatë muajit Gusht: rreth 32.1 grade celsuis

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7%.

Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga Veri-Verilindja me 20.3% nga Veriu me 19.4% dhe ajo që lajmërohet më pak është era në drejtim të Lindjes me 4 % dhe nga Jugu me 5%. Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill.

Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/sekondë.

3.6. Gjendja hidrologjike

Nga hulumtimet e shumta hidrogeologjike është konstatuar se ujërat nëntokësore ne regjionin ku shtrihet kjo zone, i takohen shumë afër sipërfaqes në thellësi nga 3 – 5 m. Janë ujëra me nivel të lirë (freatike). Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj: Sitnica, Drenica dhe Llapi. Lumi Sitnica - uji në lumenjtë janë të ndotura në shkallë të ndryshme.

Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jazë 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe kënetë 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Obiliqi, Dardhishta, Palaj, Plemetini dhe Hamidija. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap.

3.7. Flora dhe fauna

Në regjionin Obiliqit flora është e pajisur me të gjitha llojet e bimëve, nga bimët barishtore e deri te perimet. Prodhimtaria bimore, lavërtaria, prodhimtaria e drithërave, prodhimtaria e bimëve foragjere, pastaj ajo e perimeve dhe pemëve, etj. paraqesin prodhimtari të rëndësishme me prodhime kualitative dhe stabile por kishte me qenë edhe më e mirë sikur të kishim një përparim teknologjik dhe kushte ambientale më të mira.

Në tërë territorin rriten lloje të ndryshme të kafshëve si shtëpiake poashtu edhe atyre të egra. Edhe blegtoria paraqet për komunën resurs me rëndësi.

Bazuar në faunen ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Obiliqit e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në territorin jashtë vendbanimeve përpos kafshëve dhe shpezeve shtëpiake që i posedojnë fshatarët, në rrethin të kësaj zone, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj.

Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj.

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokacion kemi të bëjmë me hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi.

3.8. Karakteristikat sizmike

Territori i komunës së Obiliqit i perket zones qendrore të Kosovës, për sa i perket aspektit sizmik. Pra është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS.

Për zonat mikro - sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore.

3.9. Peizazhi

Koncentrimi i kapaciteteve për nxjerrjen, transportin dhe deponimin e qymyrit si dhe Termocentralet ekzistuese me teknologji të vjetruar për prodhim të energjisë elektrike që me emisionet aktuale krijojnë një zonë të ndotur të mjedisit.

Sipërfaqja e shtrirjes së objekteve ekzistuese të TC “Kosova A” dhe “Kosova B” dhe deponitë e hirit së bashku kanë ndryshuar peizazhin e kësaj zone. Në afërsi të TC-ve, ekziston lumi Sitnica nga i cili shpeshherë shkaktohen vërshime e tokave bujqësore dhe vendbanimet e komunitetit përreth.

3.10. Ajri

Zonat me ndotje më të madhe të ajrit në komunën e Obiliqit janë në rreze prej 8 km nga zona industriale dhe përfshin këto vendbanime: Dardhishtë, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj dhe Lajthishtë.

Procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet ku bene pjese edhe seperimi i thëngjillit përcillet me emision të pluhurit dhe gazrave siç janë: SO₂, NO_x, CO, CO₂, H₂S, bloza, thërmijat ajrore sedimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj). Pluhuri total i depozituar dhe zhurma krijohet gjate fazes se germimit, transportimit, seperimit, shkarkimit dhe deponimit te qymyrit, keto proqese ndikojne ne kualitetin e ajrit ambiental gjegjesisht rrezikojnë shëndetin e njeriut, florën, faunën dhe vlerat natyrore te mjedisit te kësaj zone.

Për shkak të dizajnëve projektuese të fundërruesve elektrostatik në TC Kosova B, pastaj mos ekzistimit të impianteve për reduktim të ndotësve si NO_x dhe SO₂, përmbajtjes së lartë të materieve inorganike në linjit dhe problemeve tjera gjatë procesit të djegies, emetimet e ndotjes në atmosferë janë më të larta se vlerat e lejuara kufitare.

TC “Kosova A” pas ndërrimit të FE, me dizajn që siguron emisionet e grimcave nën kriterin e paraparë është bërë një përmirësim domethënës mjedisor.

Emetimi i dyoksidit të sulfurit (SO₂) është i bazuar në përbërjen e qymyrit, kur sulfuri digjet, krijohet SO₂ dhe një pjesë e konsiderueshme lidhet me hirin fundërrues në kaldaj.

Në TC Kosova A e as në TC Kosova B nuk janë të instaluar De-SO₂.

Emetimi i NO_x shkaktohet prej djegies së azotit i cili është i përfshirë në qymyr dhe kryesisht nga prania e azotit në ajër.

Oksidet e azotit formohen nga reaksioni kimik i azotit dhe oksigjenit të disocuar nga ajri, që përcillet në vatër.

Për oksidimin e azotit nevojitet një nivel i caktuar i temperaturës në vatër dhe një sasi e mjaftueshme e oksigjenit. Në TC Kosova A dhe B nuk përdoret asnjë metodë për reduktimin e emetimit të NO_x.

Dyoksidi i karbonit nuk shfaq efekte direkt të dëmshme për njerëzit dhe ekosistemin, por është një faktor domethënës në ngrohjen globale.

Emetimi i CO₂ është proporcional me përmbajtjen e karbonit në karburante dhe kualitetin e derivateve të djegura.

Nuk ka metodë të disponueshme komerciale për largimin e CO₂ prej burimit shkarkues dhe opsioni më i mirë për reduktimin e emetimit të CO₂ është rritja e efikasitetit të pajimeve dhe djegia sa më racionale e derivateve apo ndryshimi në derivate me një përmbajtje më të vogël të karbonit (për shembull prej linjitit të kalohet në përdorimin e gazit natyral).

Procesi i djegies është i përcjellë me emetimin e monoksid të karbonit. Ky emetim shkakton rritje e konsumimit të derivateve dhe është si pasojë e procesit të keq të djegies-procesi jo i plotë i djegies.

3.11. Uji

Ujrat në regjionin e Obiliqit. Territorin e Komunës së Obiliqit e përshkojnë ujërat e lumenjve Sitnica, Llapi dhe Drenica. Shkalla e ndotjes së lumenjve në komunën e Obiliqit është e lartë e sidomos e lumit Sitnica si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale.

Nga proceset teknologjike lirohen : nitratet, nitritet, kloruret, amoniaku, vlera e lartë e PH, fenole etj. KEK – u është ndër ndotësit kryesor të ujërave në Sitnicë.

Pasojat e ndotjes së ujërave sipërfaqësor janë prezente në vendbanimet që shtrihen përgjatë shtratit të lumit Sitnica.

Ndotja është prezente edhe në ujërat nëntokësore e sidomos tek pusët që përdoren nga popullata lokale dhe kështu rrezikon shëndetin e saj. Pasojat janë të mëdha edhe në vet rrjedhën lumore duke ndikuar negativisht për arealin e saj.

Furnizimi me ujë - Furnizimi me ujë në komunën e Obiliqit bëhet përmes Ujësjellësit Regjional të Prishtinës, nga ujësjellësi komunal dhe në disa vendbanime furnizimi me ujë bëhet nga burimet nëntokësore (nga bunaret dhe pusët).

Furnizimi i vendbanimeve me ujë nga ujësjellësi regjional i Prishtinës dhe nga ai komunal bëhet në 13 vendbanime apo 65 % të vendbanimeve të komunës.

3.12. Toka

Në zonën dominojnë tokat Aluviale. Këto toka janë gjenetiksht të pa zhvilluara – toka në fazën e zhvillimit të vet, formohen në ultësira lumenjsh e përrrenjsh me depozitimin e materialit të hedhur më ujërat rrjedhëse.

Tokat aluviale për shkak të vetive fizike dhe kimike që posedojnë konsiderohen si toka shumë të mira për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.

Nga vitet e gjashtëdhjeta kur në këtë zonë fillojnë aktivitetet energjetike, këto toka humbin

rolin primar si toka bujqësore dhe u shndërruan në toka industrial.

Toka në këtë hapësirë është dëmtuar në dy aspekte:

Në aspektin kimik edhe në atë fizik. Toka në komunën e Obiliqit është e degraduar nga prania e deponive të hirit, mihja sipërfaqësore, deponit e jashtme, termocentralet me objektet përcjellëse, mbeturinat industrial, mbeturinat komunale, ndërtimet e egra nga komuniteti etj. Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës është se Obiliqit është 10.492 Ha ,5 ari e 19 m² (105 km²). Në këtë tërësi si pronë private është e evidentuar sipërfaqja 5683 Ha ,38 ari dhe 81 m². Prej kësaj sipërfaqeje me kulturë mal është 469 ha ,35 ari dhe 82 m² ndërsa pjesa tjetër është zonë e banimit dhe tokë bujqësore. Pronë shoqërore sipas evidences së Drejtorisë për Kadastër është 4809 Ha.

3.13. Zhurma

Zhurma paraqet problem serioz për shëndetin e punëtorëve. Nuk ka të dhëna nga monitorimi i nivelit të zhurmës në afërsi të depotit për magazinimin e vajit ushqimor të përdorur.

Por në bazë të pozitës ekzistuese të lokacionit që gjendet, në afërsi nuk ka ndonjë aktivitet tjetër industrial që do të ndikojnë në gjenerimin e zhurmës.

Mundë të konstatojmë se objektet për magazinimin e vajrave ushqimore të përdorura, nuk gjeneron dhe nuk kemi ndonjë zhurmë të përhershme që do të ndikonte në psikikën dhe koncentrimin njeriut në këtë lokacion të ngushtë.

Zhurma prezantë në këtë lokacion, në kuptimin me të gjere – të ndikimit, mund të vijë nga aktiviteti në Termocentrale “Kosova A” dhe “Kosova B”, nga vete zhurma e tyre dhe aktivitetet në shërbim të këtyre termocentraleve, si transporti etj.

3.14. Trashëgimia kulturore

Duke e ditur rëndësinë e trashëgimisë kulturore, veprimtarisë së shoqërisë e cila ka kaluar nëpër shekuj, vërehet se ka pasur diversitet të pasur kulturor.

Në regjionin e gjere të Obiliqit ekzistojnë disa objekte të trashëguara nga e kaluara historike dhe si të tilla shërbejnë si objekte turistike p.sh. fusha e ashtuquajtur “Fusha e Kosovës”, si dhe në km’6-të të magjistrales Prishtinë – Mitrovicë, në Mazgit gjendet monumenti historik Tyrbja e Sulltan Muratit II-të (e cila daton nga koha e invadimit të Perandorisë Osmane në këto troje) .

4. PËRSHKTIIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK

Baza për prodhimin e betonit “Best Beton” sh.p.k. Milloshevë, Obiliq përbëhet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- Deponia - platoja për fraksione të agregatit
- Transportuesi i agregatit
- Traseja e furnizimit të bunkerëve me agregat
- Bunkerët e agregatit 4 x 30m³, sipas fraksioneve
- Peshorja dhe shiriti i peshores së agregatit 800 mm x 10000 mm
- Shiriti transportues i agregatit 1000 mm x 26000mm
- Siloset për çimentos 2 x 80 ton
- Pajisjet e betonit – mikseri me kapacitet 100 m³/orë prodhim i AYEM MAKINA LTD.STI – Model SBT -100, viti i prodhimit 2021
- Tabela komanduese e procesit
- Rezervuari i aditivit
- Basenet e ujit me kapacitet 1 x 250000 litra
- Kompresori industrial 1000 LT
- Objektet e fabrikës së betonit, administrata, garazhet dhe objekte tjera ndihmese - janë objekte përdhese, në funksion të stafit dhe të pajisjeve të punës.
- Rezervuari i naftës 3000 litra.
- Kompania nuk posedon rezervuar të tjerë në shërbim të betonierës por vlen të theksohet se në parcelën ngjitas në jug të parcelës (në pronësi të kompanisë) gjenden pajimet e bazës së asfaltit (tani në gjendje pasive).
- Ndërrimi i vajrave të mjeteve transportuese të renda, kryhet (dërgohen) në servise të autorizuar përkëtë qëllim,
- Funksionon baseni i trajtimit të ujerave të pas procesit, si pas standardeve, me qëllim të kthimit të tyre në proces.

- Pajisjet e procesin teknologjik ne bazën e prodhimit të betonit “Best Beton” sh.p.k.
Millosevë, Obiliq



8. Deponimi i lëndës së parë



9. Ngarkuesi - transportuesi i agregatit



10. Traseja e furnizimit të bunkerët e agregatit, si pas fraksioneve



11. Bunkerët e agregatit, sipas fraksioneve



12. Peshorja dhe shiriti i peshores së agregatit



13. Shiriti transportues i agregatit



14. Siloet e çimento



15. Përzierësja e betonit – produkti final



16. Betonjera "Best Beton" sh.p.k. Milloshevë, Obiliq



17. Rezervuari i aditivit



18. Basenet e ujit (rezervuari betonik)



19. Pajisjet tjera në funksion të betonierës

4.1. Prodhimet nga betonit

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet ma përzierjen e çimentos, fraksioneve të rrërës/gurit dhe ujit.

Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve te betonit:

- Betonet plastike: 0-16(MB 15,MB 20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Betonet plastike: 0-31.5 (MB10,MB 15, MB 20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i ajruar: 0-16 (MB 20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i ajruar 0-31.5 (MB 20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB 20, MB25, MB30, MB35)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB 20, MB25, MB30, MB35).

Përveç këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve për ndërtimin e rrugëve, ujërave, tuneleve, për konstruksione nen ujë etj, në baze të kërkesave. Në vijim figurat qe pasqyrojnë pamjet e objekteve industriale, që funksionojnë, sipas skemës teknologjike dhe përshkrimit, më lartë.

4.2.Komponentët në procesin e prodhimit të betonit

Çimentoja - paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonier përdorët çimentoja Portland.

Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale.

Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë.

Dallojmë disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm².

Çimentoja Portland nuk duhet të ketë aftësi në fortësi më të vogël se 322 Mpa.

Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200 - 400 kg për 1m³.

Agregati - guri /ose rrëra - kompania furnizohet me këtë material (fraksionet e gurit gëlqeror) për arsye të cilësisë së lart të dëshmuar furnizohet nga gurthyesit ne vend /rajon .

Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit.

Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit.

Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloruret, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit nuk guzojnë të jenë të pranishme .

Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë 1:2- 1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

Uji- është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit për furnizim, kompania e ka zgjidhur më anë të pusit dhe me anë të pompave e mbushë rezervuarin i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës dhe në pronësi të kompanisë.

Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdoret vetëm uji i pastër, ujë që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura. Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë.

Në vijim do të i jepet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- për beton të lëngshëm 6 - 8%
- për beton plastik 7 - 9%
- për beton të fortë plastik 8 -10%

Si kemi cekur në pasuset e më sipërme në këtë betonier mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar në destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të marshuesve të betonit.

Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.5mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

Fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm
Përqindja	45%	20%	35%
Sasia	824kg	366kg	642kg = 1832kg
Çimentoja	350kg		
Uji	238kg		

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme:

Hyrja		Dalja	
Agregati	1832kg	1m ³ beton	2420 kg
Çimentoja	350kg		
Uji	238kg		
Bilanci i përgjithshëm	2420kg		2420 kg

Në tabelën ne vijim po e japim një shembull për sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë me katër fraksione, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

Fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm
Përqindja	40%	15%	35%	25%
Sasia	756kg	283kg	378kg	473kg = 1890kg
Çimentoja	320kg			
Uji	220kg			

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme.

Agregati

Hyrja		Dalja	
Agregati	1890kg	1m ³ beton	2430kg
Çimentoja	320kg		
Uji	220kg		
Bilanci i përgj.	2430kg		2430kg

Çimentoja paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonierë do të përdoret çimentoja portllant.

Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoret çimentoja speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë: 200, 320, 500, 600, dhe 800 kp/cm².

Çimentoja portllant nuk duhet të ketë force në shtypje më të vogël se 320 kp/cm². Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht shpenzimi specifik i çimentos është 200-400 kg/m³.

Agregati –guri ose rëra, do të furnizohet me agregat nga gurëthyes apo edhe nga seperacionet e tjera, agregati duhet të përbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulacionit.

Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloriket, sulfatet dhe kompozimet tjera kimike që i dëmtojnë vetitë fiziko mekanike të betonit dhe nuk guxojnë të jene të pranishme.

Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë: 1:2 – 1:7, varësisht prej llojit të betonit që prodhohe

Uji - është komponentë i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidh me anë të pusit i cili është i hapur në afërsi të betonierës dhe me anë të pompave e mbushë rezervarin e ujit i cili shërben për të majtë ujë rezervë për nevojat e bazës së betonit. Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdoret vetëm uji i pastër , ujë i cili nuk përmban materie organike qe formohen nga bimët e kalbura.

Harxhimi i ujit për procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të e prodhojmë.

4.3. Përshkrimi i procesit teknologjik

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit. Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset mbushen me anë të lopatës ngarkuese me fraksione të gurit ose rërës nga depoja e fraksioneve të

agregatit, siloset janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të çelikut. Proces tjetër paraqitet mbushja e siloseve me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

a. Agregati nga të katër siloset ku në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro-pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjatë në enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjatë në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit.

Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor në enën prej nga dërgohet në mikser (përzierës).

b. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi.

Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento.

Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë.

Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

c. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos.

Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet.

Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 3m³, zgjatja e një cikli është përafërsisht 2.5 min. në varesh mëri të llojit të betonit.

Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit kryhen këto veprime:

- Sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Caktohet receptura për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
- Caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale.

Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te.

Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit.

Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llambave sinjalizuese.

Menaxhimi i procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëjë mbikëqyrjen e tërë procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumonit dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohë lidhja e sajë.

Kohë lidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse.

Përveç komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar aditivët.


Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit.

Aditivi kryesisht shtohet me ujë , ose drejtë për drejt në mikser.

Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2- 4% të masës së çimentos.

Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu ne mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik

Paraqitja skematike e procesit teknologjik të bazës së betonit



4.4.Kosto e investimi në bazën për prodhimin e betonit

Për bazën e prodhimit të betonit kompania ka bërë këto investime:

<i>Pajisjet</i>	<i>Çmimi €</i>
Bunkerët e lendes se zhavorit 4x25 m3	22 000
Siloset për çimento 2 x 105 ton	38 000
Mikserët për përzierjen e betonit	31 000
Peshorja automatike	14 000
Shiritat transportues	15 000
Rezervuaret	9 000
Gjeneratori për furnizim me rryme	24 000
Kompresori	7 000
Kamionet - mikser	19 000
Pompa e ujit	5 000
Basenat e ujit	4 000
Pullti komandues	8 000
Total	196 000

4.5. Alternativat e projektit

Janë analizuar alternativat tjera për lokacione te mundshme, por marre parasysh lokacionin aktual te Bazës së betonit, ky lokacion është vlerësuar me përparësi. Përparësitë e këtij lokacioni janë, qasja ne rrugën ku gravitojnë ne qyteti i Obiliqit dhe ka qasjedhe distance te përshtatshme për këtë aktivitet ne disa qytete te rajonit te Prishtine, Fushe Kosove, Vushtrri etj, e bene te jetë me leverdi ekonomike kjo pozite gjeografike e lokacionit te këtij projekti.

Fakti se ky lokacion i parkete parkut te biznesit te përcaktuar nga niveli komunal dhe niveli qendrore i shtetit, e bene shume te leverdishëm këtë lokacion, si ne aspektin e për tu pajisur me pëlqime dhe leje mjedisore dhe për dokumentacion tjetër tekniko-invesitiv.

Infrastruktura e ndërtuar për zone komerciale (qasja ne rruge dhe infrastrukturën tjetër) është me përparësi qe te investohet ne këtë lokacion.

Alternativat ne aspektin e sigurisë, po asht ne këtë lokacion vlerësohen me përparësi te dukshme. Alternativat e këtij lokacioni ne aspektin mjedisore, janë te qëndrueshme, sepse kemi te bëjmë me zone komerciale me gravitim te larte te lëvizjes se komunitetit te biznesit dhe konsumatorëve.

Po ashtu është shqyrtuar edhe alternativat e tipi te ndërtimit dhe është zgjedhur ky projekt, i cili plotëson standardet e sigurisë teknike dhe ndikimeve minimale ne mjedis. Gjithashtu, alternative e qëndrueshme e këtij projekti është edhe aspekti ekonomik,i zhvillimit te biznesit, ne harmoni me mjedisin dhe sigurinë – pra zhvillimin e qëndrueshëm.

5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

5.1. Ndikimet ne ajër

Ne aktivitetin e prodhimit të betonit, ndikime negative paraqiten në mjedisin jetësor, në ajrit dhe atë:

Nga procesi teknologjik për prodhimin e betonit nga ku lirohen grimcat e pluhurit të çimentos, dhe grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoret për prodhimin e betonit, grimcat e pluhurave të cilat gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të betonierës, pluhurat kanë përbërje të elementeve kimike që posedon çimentoja dhe vetë lënda minerale, pluhurat të cilat i bartin ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca më të largëta.

Kjo situatë e përshkruar, kishte më qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të pluhurit gjatë zbrazjes së çimentos nga autocisternat dhe mbushja e siloseve me çimento, gjatë sjelljes së çimentos nga siloset në mikser. Ndotja e ajrit mund të vjen edhe nga lirimi i pluhurit të çimentos drejtpërdrejt nga vendet lidhëse të gypave përcjellës (transportues) të çimentos nga mundësia e lirimit të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të gazrave nga automjeteve të transportit dhe automjeteve tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

5.2. Ndikimet në tokë

Ne aktivitetin e prodhimit të betonit dhe produkteve nga betoni, ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë dhe atë:

- Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
- Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

- Ndikim tjetër me rëndësi ne toke paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të agregateve si he depozitimi i pluhurit nga këto fraksione.
- Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta te cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve te ndryshëm nga mjetet punuese gjate furnizimit dhe ndërrimit te tyre, gjate pëlcitjes te gypave hidraulik të mjeteve punuese.
- Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga laria e makinave prodhuese, auto-mikserëve, dhe automjetet tjera transportuese.

5.3. Ndikimet në ujëra

Ndikime negative ne ujë shkaktohet:

Nga derivatet, vajrat dhe yndyrat e ndryshme te cilat derdhen ne toke ngamakinat prodhuese dhe tjera te cekura ne pasuset e më sipërm me derdhjen e tyre ne toke ndikojnë ne ndotjen e ujerave sipërfaqësore me rastin e te reshurave atmosferike si dhe ndoten e ujerave nëntokësore.

- Ne ndotjen e ujerave ndikon edhe pluhuri i cili bartet me ane të ujerave sipërfaqësor.
- Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujerave te përdorura në procesin teknologjik për prodhimin e betonit, nga larja makinave prodhuese, e automjeteve transportuese, auto - mikserëve qe përdorën për transportimin e betonit.
- Nga derdhja e ujerave te zeza,
- Nga mbeturinat metalike te koroduara mbeturinat tjera te ndryshme, etj. te cilat janë te depozituara dhe mbeturina tjera te ndryshme.

5.4. Ndikimi në peizazh

Lokacioni ku i betonierës me objektet përcjellëse, për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, ka marr pamjen e një vendi biznesor / industrial.

Gjate fazës se ndërtimit peizazhi ka pësuar një degradim i cili me masat të cilat janë marr dhe do te merren ne mbarim te jete gjatësisë se projektit, peizazhit do ti kthehet pamja ne harmoni me gjendjen e përafërt te mjedisit rrethues. Këto masa do te arrihen me aplikimin e rikultivimit.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në Betonierën për prodhimin e betonit në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqet operuese për rreth betonierës flora është pothuajse e zhdukur në zonën e ngushtë (në oborrin e betonierës), e cila duhet të rritet kultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Flora në zonën përreth është e pasur dhe ndikimet nga ky aktivitet janë minimale. Fauna në zonën përreth nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohet nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës. Gjatë kohës kur pushon aktiviteti prodhues fauna rikthehet për të zhvilluar në hapësirat e mëparshme.

5.6. Ndikimet nga zhurma

Zhurma, në kompleksin e betonierës dhe rrethine, paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj.

Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Zhurma vije si rezultat i aktivitetit prodhues kryesisht nga makinat gjatë procesit të ngarkimit, dhe transportit të betonit, gjeneratorit.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk do të kalojë 55 dB, kurse gjatë natës rrallë punohet, por edhe kur punohet nuk do të jete më e madhe se 45 dB. Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit të prodhimit të betonit mund të konkludojmë se në aspektin e zhurmës nuk do të ketë ndikime negative me të mëdha se vlerat limite të lejuara, në vendbanime, në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në këtë lokalitet.

5.7. Ndikimet në raste të aksidenteve në mjedisin jetësor dhe shëndet

Pasi që aktiviteti i betonierës, për prodhimin e betonit dhe pajimet tjera përcjellëse janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lemive përkatëse dhe njëheri kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie

te rrezikshme për mjedisin, aksidente mjedisore te mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese.
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).
- Nga mekanizmi punues mundësia e përcitëse e gypave hidraulik.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos, betonit dhe produkteve nga betoni.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion nga kycja e automjeteve transportues nga baza e betonit në rrugën magjistrale.

5.8. Ndikimet nga mbeturinat dhe menaxhimi i tyre

Mbeturinat të cilat do të gjëndërohen gjatë aktivitetit të kompanisë, të ashtu quajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në djeponitë regjionale.

Mbeturina komunale	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
20 01 01	Letra dhe karton	Jo të rrezikshme	Kontejner
20 01 08	Mbeturina të biodegradueshme nga kuzhina dhe restorani	Jo të rrezikshme	Kontejner
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 03 99	Mbeturinat komunale të pa specifikuar ndryshe	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes të pajimeve të kompanisë (dërgohen për servisim në autoservis) merren nga kompani – servisi i automjeteve ku bëhet ndërrimi i vajrave të tyre – servisi i rregullt. Gjatë aktivitetit të kompanisë nuk bëhet pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve (në rast të përpunimit dhe ricikimit).

6. MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Me qëllime të mënjanim, apo zvogëlimit të ndikimeve në mjedis të aktivitetit punës të prodhimit të betonit, në kompaninë, ndërmerren një varg masash për çështjet mjedisore – për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek me lart ndërmerren këto masa:

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit mënjanohe apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin.

- Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania ka të instaluar sistemin e filtrave me thasë në siloset që përdoren për deponimin e çimentos.
- Të gjithë gypat që nevojiten për mbushjen e siloseve me çimento, si dhe gypat të cilët e furnizojnë mikserin me çimento duhet rregullisht të kontrollohen, pjesët lidhëse mbylljen hermetikisht me mbyllje adekuate.
- Thasët e filtrave të kontrollohen rregullisht dhe nëse dëmtohen ndërrohen
- Behet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e lartë cekura të jete sa më kualitativ.
- Gjithmonë duhet të behet spërkatja me ujë e sipërfaqeve operacionale larja e platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit granulacionet e agregatit sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta le spërkatën me ujë.

6.2. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë të cilat i kemi cekur me lart ndërmerren këto masa:

- Në mënyrë të rregullt mirëmbahen stabilimentet që nevojiten për realizimin e procesit për prodhimin e betonit, mirëmbahen filtrat në siloset e çimentos, mirëmbahen gypat të cilët përdoren për përcjelljen e çimentos prej auto-cisternave gjer në silos dhe prej silosit gjerë në pajimet për prodhimin e betonit, të gjitha pjesët

lidhëse të gypave të puthiten mire me qellim të pengimit të lirimit të pluhurit.

- Merren masat e nevojshme për mos lëshuarejën e pa kontrolluar të derivateve vajrave dhe lubrifikuesve nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Është betonuar platoja ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit dhe do të rregullohen sipërfaqet tjera operationale.
- Tëra sipërfaqet ku janë të vendosur gjeneratori, deponimi i vajrave dhe lubrifikanteve gjithashtu janë betonuar.
- Furnizimi me ujë për prodhimin e betonit dhe për nevoja tjera që shfrytëzohet për pastrimin e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, bëhet nga pusi.
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara të betonuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Është bërë rregullimi i platos ku deponohen materialet e nevojshme për procesin
- Është bërë rregullimi i platos ku deponohen mjetet themelore dhe sekondare që nevojiten për punët në procesin e prodhimit të betonit.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e betonierës grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë i jepen kompanive telicencuara për këtë qëllim.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm tepajisur me kapak për mbulim, me transport vetanake, apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina dërgohen në deponi regionale.
- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtës së pajimeve të betonierës deponohen në enë të posaçme që të dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

6.3. Masat për mbrojtjen e ujërave

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë merren këto masa mbrojtëse:

- Në sipërfaqet e kompleksit të kompanisë, bëhet sistemi për grumbullimin dhe

bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit të betonit dhe ujërave nga të reshurat atmosferike,

- Trajtimi i ujërave realizohet përmes basenit për grumbullimin dhe sistemin e kanaleve për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet operationale të bazës së betonit, nga sipërfaqet operationale të oficinës së mirëmbajtjes dhe garazhes së makinerisë punuese, nga sipërfaqet e depos së vajrave dhe lubrifikanteve të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.
- Pas trajtimit të ujërave në puset sedimentuese uji orientohet për trajtim të mëtejshëm në separatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operationale, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e trajtuara në separator lëshohen në gropën septike.
- Në baza të rregullta pastrohen puset sedimentuese të ujërave të ndotura.
- Gropa septike pastrohen nga kompanitë e licencuara.
- Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet ndërtuar e pastaj të lirohen në recipient të pastërta.
- Ujërat që grumbullohen dhe trajtohen, janë të gatshme për tu ripërdorur në procesin teknologjik të prodhimit të betonit dhe për spërkatje dhe ujitje të oborrit.

6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Matjet e zhurmës bëhen në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore për mbrojtjen nga zhurma. Për vlerësimin e rezultateve, matjet e fituara krahasohen me vlerat limite të lejuara dhe merren masa për uljen e zhurmës, nëse ka tejkalimi vlerave të lejuara. Në varsh mëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

Me qëllim të uljes së vlerave të zhurmës, bëhet kujdes në mirëmbajtjen dhe lubrifikimin e pajimeve të renda punuese dhe masa tjera shtese, sipas specifikave të pajisjeve dhe burimit të zhurmës.

6.5. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

Bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Behet plani i mbrojtjeve nga zjarri. Oborri i betonierës, sipërfaqet punuese të mirëmbahen në vazhdimësi për të qenë të rrethuara – mbrojtura nga faktorë të jashtëm.

Merren të gjitha masat për evitim të derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera.

Te merren të gjitha masat e sigurisë për kyçjen e automjeteve transportuese në rrugën magjistrale pa penguar komunikacionin dhe merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7. MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE

Objektivat e ri kultivimit

Pas përfundimit të jetëgjatësisë së betonierës kjo varet nga gjendja e pajimeve dhe nga pronari se a do të vazhdojë me këtë projekt me blerjen e pajimeve të reja apo do të përfundojë aktivitetin e prodhimit të betonit.

Duke marrë parasysh lokacionin i cili gjendet në zonën të përshtatshme për aktivitet biznesor, si opsion tjetër që pronari të fillojë me biznes tjetër operues.

Pas afatit të përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e betonierës duhet të çmontohen dhe në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar.

Bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të inerteve.

Nga proceset teknologjike të prodhimit të betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim.

Substrate me përbërës të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një

substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e betonierës të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethin të lokalitetit.

Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Pas përfundimit të punimeve në betonier me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera.

Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku është vendosur baza e betonit, pos të lashtave bujqësore periodike të bahet me mbjelljen e fidanëve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, pasi që sipërfaqja është e rrethuar me toka punuese mund të bëhet rekultivimi me mbjelljen kulturave bujqësore periodike.

Rikultivimi teknik

Në bazë të ligjeve të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të projektit, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më pashme.

Në bazë të punimeve të kryera hartografike - pedologjike në sipërfaqet e degraduara, duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimorë e pastajtë shqyrtohen mundësitë e sanimit të efekteve të pavoritshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet.

Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga largimi i pajimeve dhe bazamenteve të betonit të bazës së betonit duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë

përgatitjen e terrenit për rikultivim teknik të sipërfaqes tokësore të degraduar.

Degradimi i tokës gjatë realizimit të projektit shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara.

Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut prej 30cm gjer në 50cm.

Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetit agrokimike dhe pedologjike.

Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohennë këtë tokë të re.

Ri kultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Për të llogaritur numrin e fidanëve për tërë sipërfaqen që do të ri kultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$N_f = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen,

a - paraqet distancën në mes rendeve

b - paraqet distancën në mes fidanëve.

Në këtë rast propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2 m.

Në pjesët ku do të behët mbjellja e fidanëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte.

Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat (gropat) në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë.

Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të stallës e

pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë.
Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidanëve.
Fidanët duhet të shoqërohen me ambalazh përkatës ne momentin e blerjes.
Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara.

Para se të mbillen fidanët, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjila me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje.

Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje.

Koha më e përshtatshme përmbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta.

Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasi të optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj.

Pas mbjelljes së silvokulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre .

Ri kultivimi biologjik

Qëllimi afatgjatë i ri kultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësor, blegtorale dhe në silvikulturë.

Ri kultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i ri kultivimit. Bimët të cilën i propozojmë në këtë projekt në sipërfaqet degraduara nga operimi i bazës së betonit janë mbjellja e fidanëve fryt dhënëse, duke e kombinuar me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike - kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

8. RAPORTIMI

Ndikimet direktet nga aktiviteti i bazës për prodhimin të betonit, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në ajër, tokë, ujë dhe zhurmë.

Këto ndikime zvogëlohen minimalisht pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre dhe si të tilla mund të monitorohen, në perioda të caktuara dhe të raportohen tek institucionet – MMPHI.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues mjedisore, sipas obligimeve që dalin nga pëlqimi mjedisore, përkatësisht leja mjedisore.

Monitorimi i mjedisit bëhet konform legjislacionit mjedisor, në fuqi dhe të menaxhohet nga ekspertët e kompanisë, apo të angazhuar për këtë qëllim, duke kryer analizat në institute adekuate dhe raportohen në Ministri të Mjedisit, sipas kërkesës së tyre.

Raportimi do të kryhet nga udhëheqja e kompanisë nga aktiviteti i bazës për prodhimin të betonit gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë në bazë të legjislacionit mjedisore dhe kërkesave të Ministrisë së Mjedisit.

Ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse, sipas kërkesës së tyre dhe me transparencë ndaj komuniteti lokal.

9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE

9.1. Përshkrimi i shkurtër i objekteve dhe pajisjeve

Baza për prodhimin e betonit përbehet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

Baza për prodhimin e betonit përbehet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- *Deponija - platoja për fraksionet e agregatit*
- *Transportuesi i agregatit*
- *Traseja e furnizimit të bunkerëve me agregat*
- *Bunkerët e agregatit, sipas fraksioneve*
- *Peshorja dhe shiriti i peshores së agregatit*
- *Shiriti transportues i agregatit*
- *Silokset për çimentos*
- *Pajisjet e betonit – mikseri*
- *Tabela komanduese e procesit*
- *Rezervuari i aditivit*
- *Basenet e ujit*
- *Kompresori për furnizim me ajër*
- *Objektet e fabrikës së betonit, administrata, garazhet dhe objekte tjera ndihmese në funksion të stafit dhe të pajisjeve të punës.*
- *Ndërrimi i vajrave të mjeteve transportuese të renda, kryhet (dërgohen) në servise të autorizuar përkëtë qëllim,*
- *Objekti i përcjellës, në shërbim të këtij aktiviteti, garazh, depo, gardërobë, banjo, etj*

9.2. Ndikimet në mjedis

Përshkrimi i aktiviteteve të cilat kanë ndikim të theksuar në mjedis:

Ndikimet në ajër

- *Nga procesi teknologjik i prodhimit të betonit, grimcat e pluhurit të çimentos*
- *Grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoren për prodhimin e betonit*
- *pluhurit i cili lirohet dhe emitohet gjatë zbrazjes së çimentos nga auto cisternat dhe*

mbushja e siloseve me çimento

- *pluhuri i cili emitohet gjatë sjelljes së çimentos nga siloset në auto mikser*
- *pluhurit i cili lirohet në hapësirat punuese*
- *përhapjes së pluhurit nga deponit e fraksioneve dhe hapësirave punuese gjatë paraqitjes të erërave*
- *Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë dhe automjeteve të tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.*

Ndikimet në ujë

- *Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasusete më sipër të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.*
- *Nga derivatet dhe vajrat të cilat krijohen në sipërfaqet e objektit të riparimit të mjeteve ngarkuese dhe transportuese.*

Ndikimet në tokë

- *Gjatë realizimit të procesit teknologjik të prodhimit të betonit mund të identifikohen.*
- *Humbja e një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës .*
- *Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese.*
- *Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve*

9.3.Masat mjedisore

- *Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha përmjedisin.*
- *Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania ka të instaluar sistemin e filtrave me thasë në siloset që përdoren për deponimin e çimentos.*

- Në sipërfaqet e kompleksit të kompanisë, bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit të betonit dhe ujërave nga të reshurat atmosferike,
- Trajtimi i ujërave realizohet përmes kolektorit për grumbullimin dhe sistemin e kanaleve për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet operacionale të bazës së betonit.
- Masat për parandalimin e derdhjeve dhe evidentimin e derdhjeve të derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese.
- Menaxhimi i mbeturinave - të mbahet evidencë dhe ruajtja e shënimeve për sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin e mbetjeve nga mbeturinat, me qëllim që të vërtetohet dalja e mbeturinave në këtë lokacion (vendi për grumbullimin e mbeturinave).
- Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e baza për prodhimin e betonit.
- E tërë sipërfaqja e kompleksin e bazës për prodhimin të betonit permanent mirëmbahet
- Në rastet kur kemi rrjedhje eventuale të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mundë të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik të cilat me lopata mbledhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo derisa të merën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre


10. PËRFUNDIMI

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në objektet e Bazës për prodhim të betonit "Best Beton" sh.p.k. të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë si dhe duke pasur parasysh kapacitetin e prodhimit dhe mjedisin rrethues të lokacionit mundë të përfundojmë se: Funksionimi kontinual i "Best Beton" sh.p.k. baza për prodhimin e betonit, është analizuar dhe përshkruar mjaftueshëm lidhur me ndikimet në mjedis dhe rrezikun eventuale që paraqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Andaj këto informata do të jenë të mjaftueshme për MMMPH&I të marrë vendimin për pëlqimin mjedisor për bazën për prodhimin e betonit "Best Beton" sh.p.k.

SHTOJCA 1

SKEMA TEKNOLOGJIKE E BAZËS PER PRODHIMIN E BETONIT "BEST BETON"SH.P.K.



Kosto e investimit në bazën për prodhimin e betonit BEST BETON SH.P.K. Milloshevë, Obiliq

<i>Pajisjet</i>	<i>Çmimi €</i>
Bunkerët e lendes së zhavorit 4x25 m ³	22 000
Siloset për çimento 2 x 105 ton	38 000
Mikserët për përzierjen e betonit	31 000
Peshorja automatike	14 000
Shiritat transportues	15 000
Rezervuaret	9 000
Gjeneratori për furnizim me rrymë	24 000
Kompresori	7 000
Kamionet - mikser	19 000
Pompa e ujit	5 000
Basenat e ujit	4 000
Pullti komandues	8 000
Total	196 000



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për
Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI
lëshon:

Nr. i licencës: 23/19/24

LICENCË

Raif BYTYQI
Dr.sc.Inxh.i mjedisit

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM- së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

811457929

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

BEST BETON SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

BEST BETON

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:

Poslovni tip:

Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Društvo sa ograničenom odgovornošću

Limited Liabilities Companies

Adresa:

Adresa:

Address:

Rr. "Holger Petersen", Prishtina e Re, Kompleksi "Park Residence", .
Prishtinë

Data e regjistrimit:

Datum registracije:

Date of registration:

22/09/2020

01/03/2024

Data / Date / Datum



Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10179811**



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
811457929

Aplikacioni / Application / Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject:
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:
Filling date: 17/09/2020
Datum:

Data e pranimit:
Reception date: 17/09/2020
Datum primljenje:

Numri i protokollit:
Protocol number: 13010681220
Broj protokola:

Biznesi / Business/ Biznis

Tipi i biznesit
Business Type
Tip biznisa
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Limited Liabilities Companies
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:
Business name: BEST BETON SH.P.K.
Naziv biznisa:

Emri tregtar:
Trgovačko ime: BEST BETON
Commercial name:

Adresa
Address
Adresa
Rr. "Holger Petersen", Prishtina e Re, Kompleksi "Park Residence", .
Prishtinë

Data e themelimit:
Date of establishment: 22/09/2020
Datum osnivanja:

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital: € 10,000.00
Totalni kapital:

Numri i punëtorëve:
Number of employees: 5
Broj radnika:



Informata mbi biznesin
Information about business
